



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 108, datë 19.10.2022

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 290.358.720 (DYQIND E NËNTËDHJETËMILION E TREQIND E PESËDHJETË E TETËMIJË E SHTATËQIND E NJËZETË) LEKË PËR INVESTIMIN ME OBJEKT “REHABILITIMI I ZONËS QË PREKET NGA ZGJERIMI TERRITORIAL I VARREZAVE TË QYTETIT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.25, datë 05.03.2021 “Për miratimin e shpronësimit për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 290.358.720 (dyqind e nëntëdhjetëmilion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë me tvsh për objektin “Rehabilitimi i zonës që preket nga zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit”, në dy vite financimi 2022-2023, sipas tabelës së mëposhtme .

Objekti	Vlera e plotë	Financimi 2022	Financimi 2023
Rehabilitimi i zonës që preket nga zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit	288.000.000 lekë	75.383.024 lekë	212.616.976 lekë
Mbikëqyrja	2.106.000 lekë	500.000 lekë	1.606.000 lekë
Kolaudimi	252.720 lekë		252.720 lekë
Totali	290.358.720 lekë	75.883.024 lekë	214.475.696 lekë

2. Financimi prej 75.883.024 (shtatëdhjetë e pesë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tremijë e njëzetë e katër) lekë me tvsh për vitin 2022, do të sigurohet nga fondet e pa përdorura nga objektet si më poshtë vijon:

a. “Rehabilitimi i fasadave të pallateve” përfshirë vlerën e investimit, të mbikëqyrjes dhe kolaudimit në vlerë totale 25.489.400 (njëzetë e pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntëmijë e katëqind) lekë me tvsh, pasi ky investim do të realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

b. “Ndërtim i godinave për zyrë tek Ndërmarrja Rruga” përfshirë vlerën e investimit, të mbikëqyrjes dhe kolaudimit në vlerë totale 50.393.624 (pesëdhjetmilion e treqindnëntëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e njëzetekatër) lekë me tvsh.

3. Financimi për vitin 2023 në vlerën prej 214.475.696 (dyqind e katërmëdhjetëmilion e katërqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë me tvsh, do të parashikohet në PBA 2023-2025.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 20.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 812 / prot.
2

Durrës, më 27. 10. 2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.108 datë 19.10.2022 :

Për miratimin e përdorimit të fondit prej 290.358.720 (dyqind e nëntë dhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë për investimin me objekt “Rehabilitimi i zonës që preket nga zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

